



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 801/1 Prot.

Tiranë, më 13 . 07 . 2023

V E N D I M

Nr. 132, Datë 13 . 07 . 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, shkoronja “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, mori në shqyrtim ankesën me nr. 136 Regj, datë 30.06.2023, paraqitur nga shtetasi R. Q, kundër Radio Televizionit Shqiptar, me pretendimin për diskriminim për shkak të bindjes fetare.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në parashtrimet e sjella pranë Komisionerit, subjekti ankues, R. Q, informon Komisionerin lidhur me shqetësimin e pretendimin e tij për diskriminim nga ana e Radio Televizionit Shqiptar (RTSH), të cilin e shpjegon si më poshtë vijon:

“Radio Televizioni Shqiptar për të disatën herë tregohet diskriminues ndaj komunitetit mysliman. Dje indirekt e ka quajtur organizimin e faljes së Bajramit në shesh, si një gjë jonormale, ndërkohë që ky aktivitet është mëse normal, i ligjshëm, edukativ e tradicional prej vitesh tashmë”.

Ankuesi i ka bashkëlidhur formularit të ankesës, në cilësi prove, një foto të printuar nga faqja zyrtare e facebook-ut të RTSH-së, ku citohet: *“Pas përfundimit të faljes së Kurban Bajramit, sheshi “Skënderbej” do i rikthehet aktivitetit normal për t’u shfrytëzuar nga qytetarët”.*

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

Në përfundim të ankesës së tij, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri që të paralajmërojë RTSH-në, të mos përdorë më gjuhë diskriminuese ndaj komunitetit mysliman.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1, të Ligjit Nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD-së, përcaktohet se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

Bazuar në nenin 4, të ligjit LMD-së, përcaktohet se: “1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.”

Bazuar në nenin 32, pika 1, të LMD-së, përcaktohet se: “1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;”

Bazuar në nenin 33, pika 1, të LMD-së, përcaktohet se: “1. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal.”

Bazuar në nenin 33, pika 4, të LMD-së, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) është anonime; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një

ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt.”

Bazuar në nenin 32, pika 3, të LMD-së, përcaktohet se: *“Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”*

Bazuar në nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;”*

Bazuar në nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”*

Bazuar në nenin 33, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative. 2. Në procedurën administrative janë gjithashtu palë edhe mbajtësit e interesave publikë të autorizuar me ligj, si dhe mbajtësit e interesave kolektivë apo interesave të gjerë të publikut, nëse këta interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative.”*

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës dhe mbështetur në faktet dhe pretendimet e parashtruara nga subjekti ankues, Komisioneri vlerëson se bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “b” të LMD-së, ankesa nuk duhet të pranohet si e papajtueshme me dispozitat e ligjit, për arsyet e cituara më poshtë.

Së pari: Bazuar në nenin 4, të LMD-së, të marrë së bashku me nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, janë subjekte të ligjit dhe mund t’i drejtohen Komisionerit të gjithë personat fizikë dhe juridikë, si dhe çdo subjekt i së drejtës i parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Nenet 32/a dhe 33/1, të LMD-së, i njohin të drejtën çdo personi ose grupi personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, për të paraqitur ankesë para Komisionerit. Këto dispozita të marra së bashku me nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, kërkojnë që një person ose grup personash të kenë një interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative. Pra në rastin konkret, që subjekti ankues të legjitimohet si palë në procedurën administrative para Komisionerit duhet që të ketë një interes legjitim të drejtpërdrejtë.

Komisioneri vlerëson se, ankuesi, pretendon se është diskriminuar i gjithë komuniteti mysliman përmes gjuhës së përdorur në postimin e faqes zyrtare të facebook-ut të RTSH-së, pra, ka shprehur pretendimet e tij në emër të të gjithë anëtarëve të këtij komuniteti.

Komisioneri vëren se, në këtë ankesë, subjekti pretendon se fjalët dhe shprehjet e përdorura kanë të bëjnë me komunitetin në përgjithësi. Në këtë mënyrë, ankuesi nuk provon se ka një interes të drejtëpërdrejtë dhe personal. Ankuesi si individ, nuk mund t'i drejtohet Komisionerit për të arritur respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave apo interesave publike që i drejtohen një komuniteti në tërësi apo një grupi shoqëror.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues, duke mos patur një interes legjitim të drejtëpërdrejtë dhe personal nuk ka legjitimitet aktiv për të paraqitur këtë ankesë.

Së dyti: Komisioneri vlerëson se bazuar në nenin 4 , pika 1, të LMD-së, dhe nenin 33, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, legjitimohen për të qenë palë në procedurën administrative para Komisionerit edhe mbajtësit e interesave publikë të autorizuar me ligj, si dhe mbajtësit e interesave kolektivë apo interesave të gjerë të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen.

Në këtë kuptim, për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave apo interesave publike në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit, legjislacioni në fuqi ka legjitimuar për të qenë palë në një procedurë administrative, mbajtësit e interesave publike/kolektivë, që mund të jenë organizata të ndryshme shoqërore të njohura me ligj dhe që kanë si qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut, komunitete fetare, sindikata, etj.

Në këtë kontekst, është praktikë e Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që kur shqetësimi apo diskriminimi i pretenduar nuk i adresohet personalisht një personi, por prek një komunitet në tërësi, pra cenon interesa kolektivë apo publikë, ankesa të formësohet nga një organizatë me interes të ligjshëm dhe jo nga çdo individ.³

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, *në parim*, lidhur me një çështje që i përket interesit publik dhe nuk ka të bëjë me interesin e drejtëpërdrejtë dhe personal të ankuesit, për të bërë një ankesë para Komisionerit do të legjitimoheshin subjektet që janë mbajtës të interesave kolektive apo interesave të gjerë të publikut në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit.

³ Vendimi Nr.62, datë 17/06/2020, Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, Qendra për Advokim Social, Qendra për Aksion Komunitar dhe Qendrea T'reja, kundër Deputetit të Kuvendit, z. M. M;

Vendimi Nr.63, datë 17/06/2020, Shoqata "Disutni Albania", "Lëvizja për Mbrojtjen e të Drejtave Rome" dhe "Amare Roma"; kundër Deputetit të Kuvendit, z. M. M;

Vendimi Nr. 64, datë 17/06/2020 Shoqata "Rromano Kham", kundër Deputetit të Kuvendit, M.M;

Vendimi Nr.15, datë 30/01/2019, Shoqata Ilinden, kundër Institutit të Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri";

Vendimi Nr.36, datë 05/03/2019, Fondacioni Down Sindrome Albania kundër Bio Save Tirana;

Vendimi Nr.120, datë 09/09/2019, Fondacioni Down Sindrome Albania kundër Deputetit të Kuvendit, z. M.M.

Vendimi Nr.125, datë 01/08/2014, Shoqata "Aleanca kundër Diskriminimit LGBT" dhe Shoqata "Të bashkuar pro kauzës LGBT", kundër subjektit politik Aleanca Kuq e Zi.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe për rrjedhojë ankesa nuk duhet të pranohet.

Së treti: Bazuar në nenin 33, pika 4, të LMD-së, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ...ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, Komisioneri vlerëson se pretendimi i ankuesit se shprehja e përdorur (“sheshi do t’i rikthehet aktivitetit normal”), në mënyrë indirekte përbën gjuhë diskriminuese kundrejt komunitetit mysliman të Shqipërisë, edhe nëse ankesa do të pranohet për shqyrtim, hapatazi është e pabazuar, për arsyet e mëposhtme:

- a) Nga një verifikim i bërë në faqen zyrtare të facebook-ut të RTSH-së, me datë 06.07.2023, ky postim nuk rezulton të jetë në këtë faqe aktualisht.
- b) Por, edhe nëse do të vijonte të ishte i postuar në faqen e RTSH-së, Komisioneri gjykon se, në një vlerësim në pamje të parë, shprehja e përdorur nuk përbën as gjuhë diskriminuese, dhe as paragjykim për komunitetin mysliman të Shqipërisë.

Referuar Fjalorit të Gjuhës Shqipe, vetë termi “normal/normale” shpjegohet si më poshtë:

“Normal - që është ose që bëhet në përputhje me zhvillimin e rregullt e të zakonshëm të gjërave; i rregullt, i zakonshëm. Psh: gjendje normale, zhvillim normal, në kushte normale etj.

Normale - diçka që është ose që bëhet në përputhje me zhvillimin e rregullt e të zakonshëm të gjërave.”

Lidhur me pretendimin e ankuesit dhe bazuar në sa më sipër, Komisioneri thekson faktin, se në gjuhën e përdorur në postimin në faqen e facebook-ut të RTSH-së, lidhur me faktin se sheshi do t’i rikthehet normalitetit për t’u shfrytëzuar nga qytetarët, nuk ka nota diskriminuese apo paragjyquese kundrejt komunitetit mysliman të Shqipërisë, as të drejtëpërdrejta, as të nënkuptuara, por është thjesht një informacion, raportim rutinë në faqen e RTSH-së, në kuadër të përfundimit të zhvillimit të aktivitetit/ritualit fetar, me rastin e festës së Kurban Bajramit. Në kontekstin që, sheshi do t’i rikthehet gjendjes normale, asaj për të cilën ai dhe është krijuar për të funksionuar e për t’u përdorur nga dhe për qytetarët në përditshmërinë e tyre.

Në funksionalitetin e tij, sheshi është krijuar për përdorimin nga qytetarët e lëvizjen e tyre dhe ky është përdorimi normal i tij. Mirëpo në raste të tjera, të cilat janë përjashtimore apo të veçanta (pasi nuk janë të pëditshme a përleshme), siç mund të jenë rastet e festave, koncerteve të mbajtura në shesh apo aktiviteteve të tjera me natyrë kulturore, tregtare, reklamuese (panairat, tendat e vendosura për qëllime ekspozimi, tregtimi, etj), apo dhe aktivitete me natyrë politike; sheshi vihet në dispozicion të këtyre grupeve e ngjarjeve të veçanta, gjë e cila përbën një përjashtim nga gjendja normale, rutinore e përditshmërisë së përdorimit të tij nga qytetarët.

Pas përfundimit të këtyre aktiviteteve, sheshi i rikthehet sërish funksionalitetit për të cilin dhe është krijuar, pra, përdorimit të tij nga qytetarët në përditshmërinë apo rutinën normale të tyre.

Në këtë kuptim, Komisioneri thekson faktin se fraza e përdorur në rastin në fjalë nuk ka ngjyrimë apo konotacion fyese, paragjykes e diskriminues kundrejt komunitetit të respektuar mysliman të Shqipërisë.

Gjatë aktivitetit të tij, në rastet kur Komisioneri ka konstatuar përdorim të një gjuhe të tillë, ka dënuar përdorimin e gjuhës fyese dhe intolerancës ndaj një komuniteti të caktuar. Gjatë trajtimit të rasteve të ngjashme, Komisioneri ka kërkuar nga subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, si masë rregulluese të ndërhyjnë në rregullimin e zgjidhjen e problematikës së evidentuar, në mënyrë që situata diskriminuese e pretenduar të marrë zgjidhjen e duhur e të mos përsëritet më në të ardhmen.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të sa më sipër, Komisioneri konstaton se, pretendimi për diskriminim kundrejt komunitetit mysliman të Shqipërisë, nisur nga shprehja e përdorur në postimin në fjalë në faqen e facebook-ut të RTSH-së, është haptazi i pabazuar dhe për rrjedhojë, ai nuk mund të pranohet për të vijuar më tej me procedurën e shqyrtimit të tij.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronjën “a”, nenin 33, pika 4, shkronjën “b” dhe “ç”, nenin 33 pika 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me nr. 136 Regjistri, datë 30.06.2023, të paraqitur nga shtetasi R. Q, kundër Radio Televizionit Shqiptar, me pretendimin për diskriminim për shkak të bindjeve fetare.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani

KOMISIONERI

Robert GAJDA